

**LIDHSHMËRIA E AKTORËVE TË NDRYSHËM NË LUFTËN NDAJ
GJUHËS SË URREJTJES**

Prof. dr. Enes Osmançeviq

janar, viti 2019

Lidhshmëria e aktorëve të ndryshëm ndaj gjuhës së urrejtjes

Hyrje

Gjuha e urrejtjes është fenomen kompleks komunikues dhe shoqëror. Për këtë shkak, nuk ekziston përkufizim i përgjithshëm i pranuar, por ekzistojnë përkufizime që orientojnë drejt aspekteve të ndryshme të gjuhës së urrejtjes. Përkufizim më i thjeshtë dhe më i përgjithshëm është ai i Semjuell Vokerit, sipas të cilit gjuha e urrejtjes është gjuha e cila "përfshin çdo formë të shprehjes, që konsiderohet si fyese për çdo grup racor, religjioz, etnik ose kombëtar". (Voker, 1994 fq. 8.). Përkufizimet tjera theksojnë shfrytëzimin e gjuhës për sulm, shprehje pezhorative, shpifëse, frikësuese dhe shqetësuese, e cila sipas Sandra Koliverit "nxit dhunë, urrejtje dhe diskriminim" (Koliver, 1992). Disa nga përkufizimet dallojnë gjuhë raciste, propagandojnë fyerje, gjuhë e cila nënçmon ose "e vendos individin ose grupin në dritë të theksuar negative për shkak të identitetit të tyre".

Rekomandimi i Komitetit të ministrave të Këshillit të Evropës, nr. R (97) 20 për gjuhën e urrejtjes, e miratuar më 30 shtator të vitit 1997, kujton Deklaratën e Vjenës të vitit 1993 dhe Deklaratën e Pragës për mediat në shoqërinë demokratike të vitit 1994 dhe i dënon të gjitha format e shprehjes që përhapin urrejtje racore, ksenofobi, antisemitizëm dhe të gjitha format e jotolerancës. Në shtojcën e këtij Rekomandimi, "shprehja 'gjuhë e urrejtjes', i nënkupton të gjitha format e shprehjes që përhapin, nxisin ose arsyetojnë urrejtje racore, ksenofobi, antisemitizëm ose forma tjera që bazohen në jotolerancë, përfshirë edhe jotolerancën, e shprehur në formë të nacionalizmit agresiv, etnocentrizëm, diskriminim dhe armiqësi ndaj pakicave, emigrantëve dhe njerëzve me prejardhje migruese".¹

Gjuha e urrejtjes mund të përkufizohet si shprehje, që përmban porosi të urrejtjes ose mosdurimit ndaj ndonjë grupi racor, kombëtar, etnik ose fetar ose pjesëtarëve të tij. Në kohën më të re, gjuha e urrejtjes përfshin edhe gjuhë që është e orientuar drejt krijimit të urrejtjes dhe mosdurimit ndaj gjinisë dhe orientimit seksual, ndërsa gjithnjë e më shpesh ky term përfshin edhe mosdurim ndaj mendimit të ndryshëm politik, si dhe mosdurim për shkak të prejardhjes kombëtare ose shoqërore.

Përkufizimet e shumta, rregullimi ligjor dhe praktika gjyqësore e përcaktojnë gjuhën e urrejtjes ndaj: racës, orientimit seksual, përkatësisë religjioze, mohimit të krimeve, afirmimit të doktrinave totalitare, diversitetit politik dhe nacionalizimit.

Por, gjuha e urrejtjes, në kuptim më të gjerë, mund të jetë edhe gjest, grafit, parullë, simbol, shenjë, karikaturë, ilustrim, manifestim, këngë, përshëndetje, thirrje...

¹Shiko më shumë në: Përmbledhje e instrumenteve juridike të Këshillit të Evropës lidhur me mediat, Rekomandim nr. R (97) 20 Komiteti i ministrave të shteteve- anëtare për "gjuhën e urrejtjes":

http://www.coe.org.rs/REPOSITORY/137_zbornik_pravnih_instrumenata_saveta_evrope_u_vezi_sa_medijima_1.pdf

Gjuha e urrejtjes në vendet e Jugosllavisë së mëparshme

Gjuha e urrejtjes në media në shtetet e Jugosllavisë së mëparshme në njëzet vitet e fundit është konstante. Gjithsesi, gjatë viteve ka pësuar variacione në forma të ndryshme dhe me intensitet të ndryshëm nga media në media, nga shkatërimi i ish shtetit të përbashkët, përmes glorifikimit të projekteve të mëdha nacionaliste, përgatitje për luftë, por edhe gjatë luftës, si dhe pas përfundimit të luftës përmes mosdurimit kombëtar, fetar dhe racor, mosdurim ndaj orientimit seksual, urrejtja ndaj pakicave dhe urrejtja ndaj individëve dhe grupeve.²

Pasojat katastrofike nga gjuha e urrejtjes në mediat në Jugosllavinë e mëparshme gjatë luftërave në vitet nëntëdhjeta të shekullit njëzet, saktësisht i detekton profesorja universitare dhe aktiviste e lëvizjes për lirinë e shprehjes dhe të drejtat e njeriut, Svetllana Sllapshak: "Mendimi im mund të jetë shumë i izoluar, por edhe më tej jam e bindur se lufta në Jugosllavi është luftë e fjalëve, luftë e propagandës, luftë e stereotipeve, në të cilën, fatkeqësisht, vriten shumë njerëz të gjallë. Fjalët i kanë menduar dhe thënë intelektualët, ndërsa më pas janë "ricikluar" në diskursin politik publik". (Sllapshak, 1994).

Xhon S. Meril, duke analizuar rolin e mediave në luftërat që kanë ndodhur në rajonin e Jugosllavisë së mëparshme, ka arritur deri tek konkluzioni, edhe pse atë e ka formuluar më butë: "Shumica e gazetarëve e kanë vënë luajalitetin patriotik të vendit të tyre mbi prezantimin e baraspeshuar të lajmeve". (Meril, 1995, fq. 169.).

E përmendura më lartë është në pajtim me vlerësimin e përgjithshëm të raportuesit të posaçëm të Komisionit të Kombeve të Bashkuara për të Drejtat e Njeriut për veprimin dhe efektin e mediave në luftërat e Jugosllavisë së mëparshme, Tadeush Mazovjecki: "Mediat (mjetet e komunikimit masiv) në Jugosllavinë e mëparshme janë njëra nga mjetet më të rëndësishme në propagandimin e konfliktit luftarak në atë rajon". (Mazovjecki, 2007, fq. 403). "Mediat serbe kanë rol negativ në luftërat në Bosnjë- Hercegovinë dhe Kroaci. Ata shkaktojnë urrejtje nacionaliste. Midis temave që dominojnë në këto kanale mediatike gjendet arsyetimi i operacioneve ushtarake në shtetet fqinje, si dhe teoria e "konspiracionit ndërkombëtar" kundër serbëve". (Mazovjecki, 2007, fq. 427).

Rregullativa ligjore për gjuhën e urrejtjes në shtetet e Jugosllavisë së mëparshme dhe BE

Të gjitha shtetet në Bashkimin Evropian dhe rreth tij, përveç Irlandës, e rregullojnë gjuhën e urrejtjes përmes ligjeve të tyre penale, të cilat në mënyrë të detajuar e arsyetojnë përkufizimin e gjuhës së

²Shih më shumë në:

Tomson Mark, Farkëtimi i luftërave, mediat në Serbi, Kroaci dhe Bosnjë- Hercegovinë, XXO, Zagreb, 1995.

Merrill C. John, Global Journalism, Survey of International Communication, Longman Publishers, New York, 1995.

Svetllana Sllapshak dhe grup autorësh, Lufta filloi në Maksimir, Midije centar, Beograd, 1997.

Grup autorësh, Bisedë për gjuhën e urrejtjes, Qendra për hulumtimin e tranzicionit dhe shoqërisë qytetare, XXO, Zagreb, 2001.

urrejtjes, procedurave dhe sanksioneve. Disa shtete, përveç kodit penal, kanë miratuar edhe disa akte ligjore, të cilat kanë të bëjnë me çështjet e ndërlidhura me gjuhën e urrejtjes.

Nga dhjetori i vitit 2009, Kroacia në Ligjin për media elektronike e përfshin Direktivën e BE-së për shërbime audiovizuale mediatike, sipas së cilës vendet- anëtare detyrohen të sigurojnë se shërbimet audiovizuale mediatike nën kompetencat e tyre nuk përmbajnë nxitje të urrejtjes, e bazuar mbi racën, gjininë, fenë ose kombësinë.³ Në Serbi, gjuha e urrejtjes është rregulluar edhe përmes nenit në Ligjin për informim publik, sipas të cilit përkufizohet gjuha e urrejtjes dhe kushtet, nën të cilat nuk mund të ngritet padi për gjuhë të urrejtjes.⁴ Mali i Zi, përmes Ligjit për ndalimin e diskriminimit, në mënyrë eksplicite e ka inkuadruar gjuhën e urrejtjes si formë e veçantë e diskriminimit, e cila sipas ligjit dënohet me dënim me para në vlerë prej 500 deri në 20.000 euro.⁵

Ligji austriak për ndalimin e socializmit nacional e ndalon çdo aktivitet të ndërlidhur me Partinë Naciste, që nuk është për tu befasuar duke marrë parasysh ndodhitë gjatë Luftës së Dytë Botërore. Gjithashtu ky ligj e konsideron vepër penale, çdo mohim, nënçmim, lejim apo tentim që arsyetohet gjenocidi nacist ose krimeve tjera nacist kundër njerëzimit.⁶ Ky ligj është shembull i mirë, ndërsa në formë të ngjashme mund të përdoret në Bosnjë- Hercegovinë dhe shtetet e rajonit.

Në Belgjikë ekziston disa ligje për luftë ndaj diskriminimit mbi të gjitha bazat: racizëm, seksizëm dhe ksenofobi.⁷

Ligji për lirinë e mediave në Francë, në disa nene të tij e përfshin edhe gjuhën e urrejtjes, midis të cilave janë edhe mohimi ose trivializimi i krimeve kundër njerëzimit, si dhe shpifja ndaj tjerëve mbi bazën e prejardhjes së tyre, kombësisë, racës, gjinisë, orientimit seksual, identitetit gjinor ose aftësive të kufizuara.⁸

Gjermania, në vitin 2017, e miratoi Ligjin për sanksionimin e rrjeteve ("*Netzwerkdurchsetzungsgesetz*"), qëllimi i të cilave është heqja e shpejtë dhe ulja e nivelit të gjuhës së urrejtjes në rrjetet sociale".⁹ Megjithatë, konsiderohet se ky ligj, midis tjerash, kontribuoi edhe drejt censurës së lirisë së fjalës, siç është satira, ndërsa dispozitat e tij janë të paqarta dhe shumë të gjera.

Në Irlandë, në Ligjin për pengimin e nxitjes së veprës së urrejtjes, janë parashikuar gjopa me para për të gjitha veprat (të shkruara, të shqiptuara dhe të treguara), që nxisin urrejtjen ndaj personave për

³Agjencia e mediave elektronike, Kuadri juridik dhe konteksti i rregullimit, Zagreb, 2016

⁴<http://www.yucom.org.rs/rest.php?tip=vestgalerija&idSek=24&idSubSek=70&id=1&status=drugi>

⁵<http://espona.me/index.php/kolumna/3843-fatima-mededovic-begovic-mobing-i-govor-mrznje>

⁶European Union Agency for Fundamental Rights, Hate crime recording and data collection practice across the EU, Luxembourg: Publications Office of the European Union, 2018

⁷European Union Agency for Fundamental Rights, Hate crime recording and data collection practice across the EU, Luxembourg: Publications Office of the European Union, 2018

⁸European Union Agency for Fundamental Rights, Hate crime recording and data collection practice across the EU, Luxembourg: Publications Office of the European Union, 2018

⁹Article 19, Germany: Responding to 'hate speech', London: Free Word Centre, 2018

shkak të racës së tyre, ngjyrës së lëkurës, kombësisë, fesë, përkatësisë etnike dhe kombëtare ose orientimit seksual.¹⁰

Në Itali, shumë ligje kanë të bëjnë me gjuhën e urrejtjes. Kështu, ligji i konsoliduar ndalon programin audiovizual, i cili nxit sjellje jotolerante në bazë të dallimeve sa i përket racës, gjinisë, fesë dhe kombësisë. Ligji nr. 654 (i ashtuquajtur "ligji Mançino") ka të bëjë me dënimet për diskriminim racor, etnik dhe fetar, ndërsa Ligji nr. 85 ka të bëjë me krimet e lidhura me mendimin. Ligji italian për pengimin dhe neutralizimin e gjenocidit parashikon dënim me burg në kohëzgjatje prej tre deri në 12 vite për ata që publikisht do të nxisin ose mbështesin vepra, të lidhura me gjenocidin.¹¹

Ligji për veprimin e barabartë në Poloni, midis tjerash, ka të bëjë edhe me shqetësimin, prandaj viktimat e gjuhës së urrejtjes të njëjtin mund ta përdorin në ankesa dhe të kërkojnë mbrojtje, por ai është njëri nga ligjet që më së paku ka veprim dhe është i konfirmuar dobët në këtë shtet.¹²

Në Britaninë e Madhe aktual është Ligji i rendit publik, sipas të cilit vepra penale konsiderohen të gjitha fjalët dhe sjelljet e shkruara dhe të thëna, qëllimi i të cilave është përhapja e urrejtjes racore, në bazë të ngjyrës së lëkurës, racës, shtetësisë, si dhe përkatësisë etnike dhe kombëtare.¹³

Lloji i rregullativës ligjore	Shteti
Kodi penal	Të gjitha shtetet e BE dhe shtetet e rrethit (Kroacia, Serbia, Mali i Zi, Maqedonia)
Ligji për lirinë e mediave dhe informimit	Kroacia, Serbia, Mali i Zi, Franca
Ligji për barazi dhe jodiskriminim	Austria, Belgjika, Italia, Polonia
Ligji për ndalimin e gjuhës së urrejtjes	Gjermania, Irlanda

Tabela 1. Klasifikimi i zgjidhjeve të ngjashme ligjore sipas vendeve

Lufta ndaj gjuhës së urrejtjes në shtetet e BE-së

Për shtetet- anëtare të Bashkimit Evropian, shpesh theksohet se kanë ligje më të mira, por edhe zbatim të ligjeve të tyre në praktike. Megjithatë, edhe këto shtete ballafaqohen me shumë probleme përgjatë zbatimit të zgjidhjeve ligjore. Një ndër to është edhe gjuha e urrejtjes, i cili është problem gjithnjë e më i madh i shoqërisë bashkëkohore. Lufta kundër gjuhës së urrejtjes zgjat tanimë dhjetëra vite në shtetet në botë, pa dallim të rregullimit të tyre shtetëror dhe stabilitetit ekonomik.

¹⁰European Union Agency for Fundamental Rights, Hate crime recording and data collection practice across the EU, Luxembourg: Publications Office of the European Union, 2018

¹¹Article 19, Italy: Responding to 'hate speech', London: Free Word Centre, 2018

¹²Article 19, Poland: Responding to 'hate speech', London: Free Word Centre, 2018

¹³Article 19, United Kingdom (England and Wales): Responding to 'hate speech', London: Free Word Centre, 2018

Austria përmes diskursit të gjuhës së urrejtjes

Në disa vite të fundit, çështja e gjuhës së urrejtjes u bë e një rëndësie të veçantë në Austri, veçanërisht në kushtet e krizës së emigrantëve, e cila në masë të madhe përfshiu edhe këtë shtet. Edhe pse në histori, Austria ka qenë shembull i shtetit, i cili ka pranuar dhe integruar një numër të madh të emigrantëve dhe refugjatëve në shoqëri, kjo kohëve të fundit dukshëm ka ndryshuar. Më shpesh, kjo kategori përmes mediave tani përcaktohet si kërcënim për sistemin e tyre social dhe ekonomik.

Ky diskurs veçanërisht ishte i theksuar gjatë zgjedhjeve kombëtare në vitin 2017, kur Partia e Lirisë së Austrisë, parti konservatore kombëtare me orientim të djathtë, e cila hapur propagandonte sjellje armiqësore ndaj emigrantëve, refugjatëve dhe pakicave tjera etnike, fetare dhe religjioze, morri 26 % të votave dhe u bë pjesë e qeverisë shtetërore.¹⁴ Austria fuqishëm angazhohet për të drejtën e lirisë së fjalës, por paragjykimet, veçanërisht ndaj të huajve, bëhen gjithnjë e më dominuese në shoqëri. Ligji penal austriak i ndalon gjuhën e urrejtjes dhe veprat tjera, të kryera nga motive raciste, ksenofobe ose motive tjera ndaj një grupi ose anëtarëve të tij. Austriakët, gjithashtu, tentojnë të ballafaqohen me gjuhën e urrejtjes në rrjetet sociale dhe propozojnë krijimin e një institucioni të veçantë vetëm për këtë qëllim.

Sipas raportit të Ministrisë së Punëve të Brendshme të Austrisë për mbrojtjen e Kushtetutës së vitit 2016, në kohën e monitorimit nga viti 2006 deri në vitin 2016, nga viti në vit është evidente rritja e krimeve që janë të motivuara politikisht (krime raciste, antisemite, islamike dhe të ekstremit të djathtë). Megjithë ligjet që e rregullojnë këtë fushë, Austria vazhdon të luftojë ndaj gjuhës së urrejtjes në media dhe në raste të veçanta.¹⁵

"Rrjeti" gjerman

Ngjashëm si në Austri, edhe në Gjermani, në disa vite të fundit, nën presionin e krizës së emigrantëve, fokus të veçantë i kushtohet çështjeve që lidhen me gjuhën e urrejtjes. Edhe pse, duke iu falënderuar kancelares amerikane, Angela Merkel, e cila fillimisht kishte mikpritje për emigrantët dhe azilkërkuessit, retorika populiste në raport me këtë kategori në shoqëri u përforcua në drejtim të kundërt, duke filluar nga viti 2015. Kështu, shumë politikanë hapur demonstuan qëndrimet anti-emigrante në debatet publike- politike, duke tentuar të fitojnë pikë politike, kështu që mediat gjermane u vërshuan nga gjuha e urrejtjes, jo vetëm ndaj emigrantëve, por edhe ndaj të gjitha pakicave në Gjermani. Për shkak të gjendjes së re të krijuar, mediat "tradicionale" u detyruan që t'i mënjanojnë komentet në platformat e tyre onlajn".¹⁶

¹⁴<https://www.theguardian.com/commentisfree/2017/oct/16/the-guardian-view-on-the-austrian-elections-an-old-threat-in-a-new-guise>

¹⁵European Union Agency for Fundamental Rights, Hate crime recording and data collection practice across the EU, Luxembourg: Publications Office of the European Union, 2018

¹⁶Article 19, Germany: Responding to 'hate speech', London: Free Word Centre, 2018

Legjislacioni gjerman ka numër të madh të veglave për luftë ndaj "gjuhës së urrejtjes", midis të cilave edhe Kodi penal, i cili i dënon të gjithë veprat penale, të nxitura nga urrejtja me parashenjën ndaj grupit kombëtar, racor ose etnik apo individëve. Përkaj këtij fakti, në vitin 2017, gjermanët e miratuan "Ligjin për platforma dhe rrjete" (Netzwerkdurchsetzungsgesetz, i njohur si NetzDG), me të cilin kompanitë e mëdha për mediat sociale, i etiketojnë si përgjegjës jo të drejtpërdrejt për përmbajtjen e platformave të tyre dhe me anë të dënimeve administrative në afat prej 24 orëve e nxisin mënjanimin dhe bllokimin e disa përmbajtjeve nga ky lloj i mediave. Përmbajtja përfshin forma të ndryshme të "gjuhës së urrejtjes". Megjithatë, ky ligj shpesh konsiderohet si formë e re e censurës.¹⁷

Sipas hulumtimeve të Agjencisë Evropiane për të Drejtat Fundamentale, në Gjermani, krimet e gjuhës së urrejtjes nga viti 2015 zmadhohen në mënyrë të shkallëzuar (krime nga racizmi dhe ksenofobia, krimet antireligjioze dhe antisemite, krimet kundër personave me orientim tjetër seksual dhe krimet kundër strehimit të azil-kërkuesve).¹⁸

(Jo) liria e gjuhës në Francë

Franca, si vend anëtar i Bashkimit Evropian, i ka rregulluar ligjet e veta për gjuhën e urrejtjes. Kodi francez penal vërteton rrethana të vështirësuar që mund të shpien drejt dënimit të zmadhuar për veprat penale, të motivuara nga paragjykime racore, etnike, nacionaliste ose religjioze. Këto dënime të zmadhuara, zbatohen kur shkelja është e shoqëruar me fjalë të shkruara ose të thëna, fotografi, objekte ose veprime e procedura, që e dëmtojnë nderin ose autoritetin e viktimës ose grupit të personave.¹⁹

Sipas të dhënave të Ministrisë franceze të Punëve të Brendshme dhe raportit të saj për luftë kundër racizmit në të gjitha format, në periudhën nga viti 2007 deri në vitin 2017, është rritur numri i shkeljeve me karakter racist, antisemit ose antiislamik. Kështu, për shembull, numri i shkeljeve me karakter antimusliman në vitin 2007, 2008, 2009 ka qenë zero, ndërsa në vitin 2013 ky numër është rritur në vitin 226.²⁰

Ku përfundon liria e fjalës dhe ku fillon gjuha e urrejtjes në Britaninë e Madhe?

Britania e Madhe, gjithashtu, ka traditë të gjatë në luftën ndaj gjuhës së urrejtjes. Megjithatë, në disa vite të kaluara, ky problem ka rëndësi të madhe edhe për Mbretërinë e Bashkuar. Gjuha e urrejtjes ndaj emigrantëve dhe refugjatëve u bë "arma" kryesore në fushatën për Bregzitin, para referendumit

¹⁷Ibid

¹⁸European Union Agency for Fundamental Rights, Hate crime recording and data collection practice across the EU, Luxembourg: Publications Office of the European Union, 2018

¹⁹<https://theintercept.com/2017/08/29/in-europe-hate-speech-laws-are-often-used-to-suppress-and-punish-left-wing-viewpoints/>, (пристапено 13.01.2019. во 22:00)

²⁰European Union Agency for Fundamental Rights, Hate crime recording and data collection practice across the EU, Luxembourg: Publications Office of the European Union, 2018

për vazhdimin e anëtarësimit në Bashkimin Evropian në vitin 2016, ndërsa ky trend vazhdoi edhe pas përfundimit të tij.

Fushata për zgjedhjet parlamentare në vitin 2017, u zhvillua me debate politike, të cilat përmbanin gjuhë të urrejtjes. Veçanërisht, rrethanë e vështirë për komunitetin musliman në Britaninë e Madhe ishin sulmet terroriste, për shkak të të cilave ky komunitet ballafaqohet me valë të re të diskriminimit dhe gjuhës së urrejtjes ndaj tyre.²¹

Gjuha e urrejtjes në Britaninë e Madhe është përfshirë në Kodin penal, në të cilin kërkohet nga gjykatat të rrisin dënimin për çfarëdo veprë të kryer penale, duke përfshirë urrejtjen ndaj viktimës mbi bazën e përkatësisë racore, etnike, prejardhjes etnike dhe bindjes fetare. Gjithashtu, ligji britanik për rendin publik merret me gjuhën e urrejtjes, kështu që personi që përdor fjalë ose sjellje kërcënuese dhe fyese, ose publikon çfarëdo material të shkruar, me të cilin kërcënohet ose fyen, është fajtor për atë nëse ai/ajo ka për qëllim që në këtë mënyrë të shkaktojë urrejtje racore.²²

Sipas raportit të Zyrës së brendshme të Britanisë së Madhe në vitin 2016 dhe Zyrës për Krim dhe Urrejtje të Anglisë dhe Uellsit në vitin 2016/17, ka rritje vjetore të numrit të rasteve të krimeve të urrejtjes në periudhën nga viti 2011 deri në vitin 2016, të evidentuara në baza racore, religjioze, të orientimit seksual, të aftësive të kufizuara dhe transgjinore.

Për dhe kundër gjuhës së urrejtjes në Poloni

Deri paradokohësh, Polonia ishte vend i njohur si homogjen dhe monoreligjioz me përqindje të ulët të pakicave. Në atë periudhë, thuhet nuk kishte raste të regjistruara të gjuhës së urrejtjes. Pas rënies së komunizmit, autoritetet në Poloni filluan më konkretisht të merren me mbrojtjen e të drejtave të njeriut dhe ngufatjen e gjuhës së urrejtjes, e shkaktuar nga racizmi, seksizmi dhe homofobia. Sado që ajo të ishte e (pa) suksesshme, në vitin 2015 ndodhën shumë ndryshime në Poloni.²³

Në fakt, partia politike "Ligj dhe drejtësi" i fitoi zgjedhjet parlamentare, që u mbajtën vitin e njëjtë. Me fitoren e tyre, u vazhdua me censurë edhe më të fuqishme ndaj mediave dhe kontroll të institucioneve gjyqësore. Qeveria me aktivitetet e saj, madje edhe kontribuoi për zgjerimin, por edhe për promovimin e gjuhës së urrejtjes dhe jotolerancës. Kjo më mirë shihet me paraqitjen e krizës së emigrantëve, në të cilën është përfshirë edhe Polonia.

Reagimet jopërkatese dhe të ashpra të disa politikanëve udhëheqës polak ndaj asaj që ata e konsiderojnë "krizë evropiane e emigrantëve", kontribuan për praninë më të madhe dhe përforcimin e gjuhës së urrejtjes në diskursin publik. Madje, edhe mediat e financuata nga qeveria (televizionet dhe radio-stacionet shtetërore) dhe mediat private që janë pozitivisht dhe në mënyrë jokritike të

²¹Article 19, United Kingdom (England and Wales): Responding to 'hate speech', London: Free Word Centre, 2018

²²Ibid

²³Article 19, Poland: Responding to 'hate speech', London: Free Word Centre, 2018

disponuara ndaj qeverisë, e promovuan retorikën antiemigrante, përmes përhapjes së paragjyqimeve për emigrantët, të cilët paraqesin kërcënim për sigurinë kombëtare dhe paqen në vend.²⁴

Fakti se terreni për opinionin e tillë publik është përgatitur konfirmohet me rezultatet e studimit, i zbatuar në vitin 2014 nga ana e Qendrës për Hulumtimin e Paragjyqimeve pranë Universitetit të Varshavës dhe Fondacionit Sefani Batari, sipas së cilës befasueshëm një pjesë e madhe e përqindjes së polakëve pranojnë gjuhë të urrejtjes, veçanërisht ndaj hebrenjëve, romëve dhe popullatës LGBT dhe nuk shohin asgjë fyese në këtë.²⁵ Gjuha e urrejtjes në Poloni trajtohet në Kodin penal, por edhe në Ligjin për trajtim të barabartë, i miratuar në vitin 2010. Megjithatë, ligji, si i tillë, nuk arriti të sigurojë mbrojtjen e viktimave të diskriminimit mbi baza të ndryshme dhe për këtë shkak ishte i kritikuar nga ana e institucioneve evropiane dhe ndërkombëtare për mbrojtjen e të drejtave të njeriut.²⁶

Përvoja në luftën ndaj gjuhës së urrejtjes në Bosnjë- Hercegovinë

Gjuha e urrejtjes në Bosnjë- Hercegovinë është rregulluar me Kodin penal të këtij vendi (nenin 145.a), Kodi penal i Federatës së Bosnjë- Hercegovinës (nenin 163). Kodi penal i Republikës serbe (neni 390) dhe Kodi penal i rrethit Bërçko- B e H (neni 160).

Të gjitha këto ligje për gjuhën e urrejtjes, varësisht nga pasojat, parashikojnë dënime me burg prej pesë, tetë, madje edhe dhjetë vjet burg.

Megjithatë, praktika ligjore, e precizuar dhe e rreptë, zbatohen dobët. Edhe pse gjuha e urrejtjes është e pranishme në komunikimin publik në bazë ditore dhe kryesisht është e shprehur përmes mohimit të gjenocidit dhe krimeve të luftës, urrejtjes ndaj kundërshtarëve politik dhe jo-tolerancës ndaj personave me orientim të ndryshëm seksual, nga lufta e vitit 1992 deri më sot, janë përpunuar vetëm disa raste të gjuhës së urrejtjes. Shkak për këtë fakt është se protagonistët e gjuhës së urrejtjes janë politikanë dhe se gjyqësori i Bosnjë- Hercegovinës edhe më tej është joprofesional dhe i papërgatitur që t'i ndjek dhe t'i procedojë rastet e gjuhës së urrejtjes së politikanëve dhe propagandistëve partiakë.

Aktivitet më intensiv në luftën ndaj gjuhës së urrejtjes u dëshmuua në sektorin e shoqërisë qytetare, veçanërisht në fushën e vetë-rregullimit të mediave. Këshilli i Shtypit i Bosnjë- Hercegovinës është trup joqeveritar për vetë-rregullimin e mediave të shtypura, misioni i së cilit është mbrojtja e qytetarëve nga raportimi joprofesional, mbrojtja e lirisë së mediave dhe mbrojtja e gazetarëve nga ndikimet e presionet politike dhe të tjera. Këshilli i Shtypit i Bosnjë- Hercegovinës është anëtar i plotfuqishëm i Aleancës së Këshillave të Pavarur të Etikës në Mediat e Evropës- AIPCE".²⁷

²⁴Ibid

²⁵https://www.researchgate.net/publication/317313024_Hate_speech_in_Poland_-_summary_of_the_national_opinion_poll, (пристапено 13.01.2019. u 22:15)

²⁶Article 19, Poland: Responding to 'hate speech', London: Free Word Centre, 2018

²⁷Burimi: www.aipce.net

Baza e punës së Këshillit të Shtypit në Bosnjë- Hercegovinë, përkatësisht miratimi i vendimeve të Komisionit të Ankesave në bazë të ankesave të qytetarëve, bazohet mbi Kodin e mediave të Bosnjë- Hercegovinë, i cili del nga standardet ekzistuese evropiane të praktikës gazetareske. Në dhjetë vitet e fundit, Këshilli i Shtypit ka ndërmarrë një sërë aktiviteteve ndaj gjuhës së urrejtjes.

Me qëllim që të pengohet përhapja e gjuhës së urrejtjes dhe fyerja në komentet anonime të vizitorëve të portaleve të internetit, Këshilli i Shtypit në Bosnjë- Hercegovinë e filloi aksionin "Nuk jeni të padukshëm". Anonimiteti nuk do të thotë se personi nuk mund të identifikohet dhe të ndiqet nëse zbulohet përhapja e gjuhës së urrejtjes, nxitjeve, kërcënimeve dhe thirrjeve për linçim.

Aksioni "Nuk jeni të padukshëm" do të thoshte zbulim i adresave IP dhe adresave MAC si dhe ndjekja e personave që me komentet e tyre shqetësojnë publikun dhe përhapin gjuhën e urrejtjes, u shkaktojnë dëme individëve dhe u shkaktojnë dëm autoritetit të portaleve profesionale të internetit.

E rëndësishme është të theksohet se vizitorët e portaleve në ueb, që publikojnë komente me gjuhën e urrejtjes i nënshtrohen përgjegjësisë penale, sepse ata nxisin jotolerancë dhe urrejtje.

Gjithashtu, përgjegjësia është e njëjtë edhe nëse komentet përmbajnë porosi kërcënuese: Kodi penal i B e H: XV- kreu 15, vepra penale ndaj lirisë dhe të drejtave të njeriut dhe qytetarit. Kodi penal i B e H dhe Kodi Penal i RS: XVII - neni 17, vepra penale kundër lirisë dhe të drejtave të njeriut dhe qytetarit.

Aksioni "Ndal urrejtjes" ishte i bazuar tek roli aktiv i Këshillit të Shtypit me rrjetin e bashkëpunëtorëve në mediat e shkruara e onlajn për luftë ndaj gjuhës së urrejtjes. Rrjeti i bashkëpunëtorëve kishte rol që ta ndjek përmbajtjen e mediave të shkruara dhe onlajn dhe të paralajmëroje gjatë detektimit të gjuhës së urrejtjes, jo vetëm në shkrimet gazetareske, por edhe në komentet e përdoruesve.

Paralajmërimi për gjuhë të urrejtjes u evidentua për një baneri të disenjuar në mënyrë të veçantë, i cili ishte publik dhe i dukshëm, me qëllim që t'i inkurajojë këshillat redaktuese të portaleve të uebit që t'i fshinë komentet, në të cilat ka gjuhë të urrejtjes.

Koalicioni për luftë ndaj gjuhës së urrejtjes është aktiv në Bosnjë- Hercegovinë, i cili, përkaj Këshillit të Shtypit, përbëhet nga 11 organizata të huaja dhe organizata joqeveritare.

Aktivitetet e Koalicionit, përveç paralajmërimeve për rreziqet dhe pasojat e gjuhës së urrejtjes, janë edhe bërja e presionit ndaj të gjithë aktorëve të qeverisë dhe sektorit joqeveritar për luftë aktive ndaj manifestimeve të urrejtjes në sferën komunikative publike. Gjithashtu, aktivitetet kanë të bëjnë edhe me ndryshimet dhe përmirësimin e ligjeve, ndjekja e atyre që proklamojnë gjuhë të urrejtjes, përfshirjen e publikut në luftën ndaj gjuhës së urrejtjes, zbulimi i identitetit të atyre që e përdorin gjuhën e urrejtjes.

Aktivitetet e sektorit qytetar në Bosnjë- Hercegovinë ndaj gjuhës së urrejtjes janë për respekt, por, për fat të keq, të pamjaftueshme për shmangien e gjuhës së urrejtjes nga diskursi publik.

Nevojitet përfshirja e gjyqësorit, policisë dhe agjencive qeveritare, kështu që autorët e gjuhës së urrejtjes do të ndiqen penalisht në pajtim me ligjet pozitive. Gjithashtu, është e domosdoshme miratimi i zgjidhjeve të reja ligjore, që do të mundësojnë sanksionimin më efikas të të gjitha formave të gjuhës së urrejtjes dhe frymëzuesve, promovuesve dhe transmetuesve të saj.

Literatura:

- Coliver Sandra ur., *Striking a Balance - Hate Speech, Freedom of Expression and Non-discrimination*, University of Essex, 1992.
- Grupa autora, *Razgovor o govoru mržnje*, Centar za istraživanje tranzicije i civilnog društva, HHO, Zagreb, 2001
- Grupa autora, *Bosna i Hercegovina 2008: Uloga i stanje medija*, Transparency International, Friedrich Ebert Stiftung, Banja Luka, 2008.
- Ivanković Željko, *Rat i njegova medijska slika u Bosni i Hercegovini*, Status br. 3, Dijalog, Mostar, 2004.
- Joksimović Vladan ur., *Zbornik pravnih instrumenata Savjeta Evrope u vezi sa medijima*, Savjet Evrope, Kancelarija u Beogradu, Beograd, 2006.
- Lange Yasha ur., *Živjeti zajedno, Priručnik o standardima Vijeća Evrope o doprinosu medija društvenoj koheziji, interkulturalnom dijalogu, razumijevanju, toleranciji i demokratskoj participaciji*, Vijeće Evrope, Strasbourg, 2009.
- Mazowiecki Tadeusz, *Izveštaji 1992-1995.*, Univerzitet u Tuzli i Istraživačko dokumentacioni centar Sarajevo, Tuzla, 2007.
- Merrill C. John, *Global Journalism, Survey of International Communication*, Longman Publishers, New York, 1995.
- Osmančević Enes, *Demokratičnost WWW komuniciranja*, Friedrich Ebert Stiftung, Sarajevo, 2009.
- Thompson Mark, *Kovanje rata, Mediji u Srbiji, Hrvatskoj i Bosni i Hercegovini*, HHO, Zagreb 1995.
- Svetlana Slapšak i grupa autora, *Rat je počeo na Maksimiru*, Medija centar, Beograd, 1997.

- **Walker, Samuel: *Hate Speech: The History of an American Controversy***, Lincoln: University of Nebraska Press, 1994
- **Zurovac Ljiljana, Rudić Borka ur., *Promocija profesionalizmai tolerancije u medijima u BiH***, Ured Vijeća Evrope u Sarajevu, 2013.
- **European Union Agency for Fundamental Rights, *Hate crime recording and data collection practice across the EU***, Luxembourg: Publications Office of the European Union, 2018

Agencija za elektroničke medije, *Pravni okvir i kontekst regulacije*, Zagreb, 2016